



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 25.04.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Anton Quni, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së: Ministri, z. Agim Çeku, Komandanti i FSK-së, Kadri Kastarti dhe Sekretari i përhershëm i MFSK, Shkelzen Syla

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa- Safete Hadergjonaj

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtura, më 02.04.2012
3. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentes lidhur me kthimin e Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për rishqyrtim;
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtura, më 02.04.2012

Kryetari i Komisionit- A ka vërejtje për procesverbalin e datës 02.04.2012? Meqenëse nuk ka vërejtje, e konsiderojmë të miratuar procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 02.04.2012.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentes lidhur me kthimin e Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për rishqyrtim.

Kryetari i Komisionit- Në mbledhjen e kaluar si Komision e kemi diskutuar dhe kemi paraparë që, në takim për tu konsultuar të kemi Ministrin e FSK-së, Gjeneralin dhe Kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse në vendimin e Presidentes, kemi kërkesë për një paragraf i cili duhet ti shtohet Projektligjit.

Citoj paragrafin” në rast të mungesës së fondeve publike Qeveria mund të bëjë shkurtime sa i përket përfitimeve nga ligji për të mos rrezikuar sigurinë financiare të Kosovës”

Për këtë çështje kemi diskutuar si Komision, fjalën ia japim Kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa, pastaj Ministrin dhe Gjeneralit, duke kontribuar pastaj edhe anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa- Safete Hadërgjonaj- Ne si Komision kemi shqyrtuar Amendamentet të cilat janë sjell në Komision para se projektligji të miratohet në Kuvend. Me datën 13.02.2012 kemi pasur një takim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ata kanë insistuar që pjesë e projektligjit të jenë dy çështje, që sipas deklaramit të tyre ata janë pajtuar me sponsorizuesin, Ministrinë e FSK-së gjatë fazës së hartimit të ligjit, që këto dy çështje të jenë pjesë e projektligjit. Në nenin 5, i cili është përkrahur nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe nenit 27, ti shtohet paragraf i ri.

Sipas deklarimeve të FMN-së, pjesa që ka të bëjë me nenin 27 është pjesë e marrëveshjes dhe është në *letrën e qëllimit të mirë*, në të janë akorduar FMN-ja dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Për këtë çështje kemi ftuar në Komision Ministrin e Financave dhe Ministrin e FSK-së. Ministri i FSK-së, nuk ka qenë i pranishëm, të pranishëm ishin Sekretari i përhershëm i Ministrisë së FSK-së bashkë me stafin e tij.

Si Komision për Buxhet, kemi propozuar që në nenin 27 të shtohet paragraf i ri me tekstin i cili ndryshon nga ai që ka propozuar Presidentja. Në seancën plenare kamë kërkuar që ky paragraf të bëhet pjesë e ligjit meqë është pjesë e marrëveshjes me FMN-në.

Për mënyrën se si është hartuar ligji, më tepër kompetent janë Ministria e FSK-së, pasi ata e dinë që kanë pasur disa kufizime për të pasur mundësi të procedohet me projektligjin. Duke i njohur të gjitha këto rrethana, si Komision për Buxhet dhe Financa kemi propozuar Amendamentin, që të shtohet paragrafi 2 i nenit 27 të projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, që në rast të ndonjë vështirësie financiare të ketë mundësi të bëhen reduktime.

Në seancë kam shpjeguar që këto raste mund të merren paraprakisht, por edhe mund të mos ndodhin kurrë, megjithatë duhet të ju rikujtoj që edhe në ligjin e skemës sociale të cilin e kemi miratuar pak ditë më parë, është i njëjti paragraf i cili është propozuar edhe për Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, gjithashtu është edhe në ligjin e veteranëve të luftës.

Nga njohuritë që kam, Ministria e Financave nga marrëveshja që kanë bërë me FMN-në, ky paragraf është pjesë e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me skemën sociale.

Arsyeja se pse kemi ardhur deri në këtë çështje, është insistimi që kjo çështje është pjesë e marrëveshjes me FMN-në dhe duhet të figuroj edhe në ligjin për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku- Ju falënderoj si Komision i Punëve të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për qëndrimin që keni pasur me qëllimin më të mirë për të mbështetur FSK-në, kjo është vërejtur edhe gjatë seancës dhe pjesëtarët e FSK-së e çmojnë këtë fakt.

Ndoshta është e pazakontë për një Ministër, por në këtë rast Ministri i FSK-së bashkë me bashkëpunëtorët kërkon që të mbështetet vendimi i Presidentes, që nenin 27 ti shtohet edhe një paragraf. Ne mendojmë kështu pasi debati për këtë çështje po shkakton vonesa të shumta, dhe kjo ka shkaktuar pasiguri tek pjesëtarët e FSK-së. Numri i pjesëtarëve që i kanë përmbushur kushtet për tu pensionuar është 57, gjatë vitit pritet që ky numër të rritet në 73, dhe për këtë arsye ky ligj është shumë i rëndësishëm.

Çështja e dytë, si FSK jemi të thirrur për ta mbrojtur interesin e vendit, pa pyetur a dëmtohem apo jo, dhe kjo është në logjikën e ushtarit. Interesi është respektimi i marrëveshjes me FMN-në, marrëveshjen të ciline ka nënshkruar Qeveria më 20 qershor 2011, ku obligohet Qeveria që në çdo ligj të ri të inkorporohet edhe ky paragraf. Nuk është vetëm FSK-ja që mund të goditet me këtë ligj, por e tërë shoqëria.

Nëse do të ketë rast kur mund të reduktohet buxheti për pjesëtarët e FSK-së, kjo bëhet për ta ndarë fatin me të gjithë shoqërinë, pasi nuk do të ishim ndier mirë nëse vetëm FSK-ja do të ishte privilegjuar, pasi pjesëtarët e FSK-së janë në shërbim të vendit. Marrëveshja

me FMN-në është shumë e rëndësishme për Kosovën, për stabilitetin financiar që duhet ta kemi si shtet, prandaj duhet që këtë marrëveshje ta zbatojmë në përpikëri, pasi është në pyetje interesi i vendit, gjithashtu kjo çështje u është shpjeguar edhe ushtarëve e FSK-së.

Kryetari i Komisionit- Komisioni ka vepruar gjithmonë në interes të vendit, duke mos u ndarë në vija politike për çështje të ndryshme, aq më tepër për FSK-në, pa dashur të ndikoj, fjalën ua kaloj anëtarëve të Komisionit.

Rexhep Selimi- Kthimi i ligjeve është bërë një fenomen, mendoj që kjo nuk është praktikë e mirë, aq më tepër kur shfrytëzohet neni i Kushtetutës neni 84, pika 6, për kthimin e disa ligjeve në rishqyrtim, kurse qëllimi në takime po del të jetë diçka tjetër. Në këtë rast, Presidentja nuk e ka arsyetuar kthimin e ligjit mbështetur në marrëveshjen me FMN-në, por kthimin e ligjit e ka mbështetur në nenin 84, pika 6 të Kushtetutës.

Citoj nenin "Presidenti/ja ka të drejtë të kthimit të ligjit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara nëse i konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Kosovës"

Personalisht nuk e konsideroj që neni 27 i ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, është i dëmshëm për interesin e Kosovës.

Në rastin tjetër kur mund të rikthej ligjin, citoj nenin "ose kur dëmton interesat e një apo më shumë komuniteteve të saj" neni 27 nuk dëmton interesat e asnjë komuniteti në Kosovë.

Vlerësoj që kthimi i këtij ligji nuk është i mbështetur mbi arsyet që i jep Kushtetuta, por për aq sa biseduam, kthimi i këtij ligji mbështete në një marrëveshje që ka Qeveria e Kosovës me FMN-në. Prandaj vlerësoj që nuk është praktik e mirë kthimi i ligjeve në këtë mënyrë, aq më tepër që Presidentja të mos bie pre e presioneve që dalin nga marrëveshjet e Qeverisë së Kosovës. Është shqetësues fakti që pse Qeveria e Kosovës të kujdeset për buxhetin, kur dihet që për këtë vit janë 70 pjesëtarë të FSK-së që pensionohen, dhe më së shumti deri në vitin 2025, afërsisht 2500 të pensionuar. Ky numër i të pensionuarve nuk i dëmton interesat legjitime të Republikës së Kosovës siç, thirret Presidentja në Kushtetutë për kthimin e ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së.

Mendoj që e dëmton FSK-në futja e paragrafit të propozuar, edhe nëse nuk zbriten asnjëherë pensionet e pjesëtarëve të FSK-së. Dëmtimi mund të jetë për pjesëtarët e tanishëm të FSK-së, nëse atyre u rrezikohet pensioni pasi ata të kenë përfunduar mandatin e tyre, i de-motivon pjesëtarët e FSK-së, duke mos qenë të sigurt që pensioni i tyre është i garantuar pas pensionimit.

Çështja e tretë, mendoj që është fokusuar vetëm tek një kategori e caktuar e pensioneve të cilët përfitojnë nga buxheti i Kosovës, ashtu siç u tha që në skemën sociale, për veteranët e UÇK-së dhe pjesëtarët e FSK-së, e cila kategori ka respekt të madh për atë se çfarë përfaqësojnë në shoqërinë e Kosovës.

Ne mund të jemi të sigurt që kurrë nuk do të ketë shkurtime të pensioneve të pjesëtarëve të FSK-së, por kjo krijon pasiguri tek pjesëtarët e FSK-së, ndërsa në anën tjetër nuk do të

ishte e pranueshme nëse do të shkurtoheshin pensionet e pjesëtarëve të FSK-së në rast të zvogëlimit të buxhetit, dhe do të rriteshin në rast të rritjes së buxhetit. Në këtë rast nuk parashihihen të rriten pensionet në rast të rritjes së buxhetit, gjë që dihet që do të ketë rritje të tij por, sanksionohet të shkurtohen vetëm nëse do të ketë ulje të buxhetit.

Vlerësoj që nuk është i pranueshëm, aq më tepër nuk është i mbështetur në Kushtetutë kthimi i Ligjit për Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, dhe si të tillë mendoj që nuk duhet pranuar.

Fatmir Xhelili- Qëndrimet e Komisionit edhe në të kaluarën kanë qenë gjithherë unike, duke analizuar projektligjet nenë për nenë, dhe paragraf për paragraf, për problematikat që përfshiheshin brenda tyre. Tani jemi në situatën që Ligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së është kthyer nga Presidentja. Kthimi ndodh pa fajin tonë, pasi gjithmonë jemi nisur nga qëllimi i mirë për të mbrojtur vlerat, qytetarët, në mënyrë që segmentet e sigurisë të institucioneve tona të jenë të akomoduar dhe me një mirëqenie adekuate.

Fatmirësisht, numri i pjesëtarëve të FSK-së të planifikuar për tu pensionuar, nuk është i madh. Indikatorët e rrjedhës financiare të Republikës së Kosovës në katër vitet e fundit janë të qëndrueshme, ku buxheti me një fond prej 700ml.€ është rritur në 1miliard e 400ml., dhe planifikimet buxhetore kanë qenë të mirë planifikuar konform të hyrave shtetërore dhe i është kushtuar kujdes shpërndarjes së buxhetit për segmentet e sigurisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, zjarfikësve, me të cilën gjë Qeveria ka dëshmuar që është kujdesur për këta zyrtar, por jo vetëm.

Pavarësisht sqarimeve për kthimin e Ligjit për Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, duhet të jemi të kujdesshëm që të mos i prishim marrëdhëniet me FMN-në, organizatë e cila ka mbështetur shtetin e Kosovës në mënyrë që sistemi financiar dhe fiskal të jetë i qëndrueshëm dhe një sistem që nuk rrezikon me vendime *ad-hoc*, duke sjell vendin në situata të vështira ekonomike dhe financiare, gjë që ndodh me shume shtete të rajonit. Për këtë qëllim FMN-ja merr masa paraprake, duke përfshi në ligje paragrafë të cilat kushtëzojnë, në mënyrë që eventualisht të përcaktohen shkurtime eventuale, duke i dhënë prioritet segmenteve që do të funksionojnë në atë kohë.

Hapësirat që krijon FMN-ja, qoftë me ndihmat e premtuara për këtë vit dhe vitin e ardhshëm, por edhe mundësinë e marrjes së fondeve nga Banka Botërore në të ardhmen, fal preferencave të FMN-së, i propozoj Komisionit që të mbështesim dhe të pranojmë propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që paragrafi të vendoset në ligjin ekzistues. Qëllimi i FSK-së dhe miqve ndërkombëtar ka qenë të nxirret kjo kategori që kanë qenë ish pjesëtarë të TMK-së dhe pjesëtarë të FSK-së, për tu mundësuar një mirëqenie në rrethanat që jetojmë. Kujdesi që ka treguar Ministria e Financave, Qeveria or rrjedhat ekonomike dhe financiare të Kosovës, nuk do të vijmë në situata të tilla, prandaj ftoj anëtarët e Komisionit që pranojmë paragrafin e propozuar në mënyrë që të lehtësojmë punën e FSK-së dhe të vazhdohet me rrjedhat normale.

Anton Quni- Në kohën kur Ligji për Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së ka qene në diskutim në Komision, organizuam takimin me Ministrinë e FSK-së, dhe shprehem

pakënaqësitë për ligjin, për faktin se ky ligj nuk ofron benificione të mjaftueshme për të pensionuarit e FSK-së, por duke marrë parasysh rrethanat, dinamikën u pajtuam me pikat kryesore.

Paraqitja e kësaj çështje, me kthimin e ligjit nga Presidentja, paraqet dilema morale, në mes të asaj që a të mbrohet një kategori e cila do të pensionohet dhe njëkohësisht mos të pengohet zhvillimi i FSK-së. Jam i mendimit që nëse do të pensionoheshin të gjithë pjesëtarët e FSK-së, 2500 pjesëtar, nuk e di çfarë implikimi buxhetor do të ketë, pasi është implikim minimal dhe nuk varet siguria financiare nga shkurtimet e Pensioneve për këta pjesëtar.

pensionimi i pjesëtarëve të FSK-së, nuk do të thotë ndarje fizike dhe shpirtërore nga FSK-ja, edhe si të pensionuar llogarisin ti qëndrojnë afër të gjitha problemeve të FSK-së, gjithashtu edhe FSK-ja duhet të llogarit në këtë kategori në raste emergjente, paralufte por edhe të luftës, prandaj këtë kategori duhet ta trajtojmë në vazhdimësi pavarësisht nëse janë të pensionuar apo jo.

Është diskriminuese trajtimi i disa kategorive, kjo temë del në sipërfaqe kur janë në pyetje veteranët e luftës, të pensionuarit e FSK-së, dhe nuk kemi pasur raste të ngjashme për kategori të tjera. Qeveri për ti qëndruar besnike marrëveshjes që ka pasur me FMN-në, mundet që me një ligj të veçantë, kur kemi kriza të cilat parashikohen atëherë me atë ligj të sanksionohen jo vetëm të pensionuarit por edhe Ministrat, deputetët dhe kështu fati ndahet së bashku, dhe jo vetëm të pensionuarit e FSK-së.

Emin Gërbeshi- Pas marrjes së vendimit nga Presidentja për kthimin e Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, them që nuk pajtohem me këtë vendim të Presidentes, pasi cenon të drejtën elementare për gëzimin e të drejtës së pensionit dhe është shkelje e të drejtave të njeriut. Qëndrimi i FMN-së për këtë çështje më habit, aq më tepër qëndrimi i institucioneve të Kosovës përballë mendimit të FMN-së.

Pyetja që shtroj është. A e rrezikon stabilitetin financiar të një shteti pensionimi i një numri të caktuar i pjesëtarëve të cilit do institucion?

Nuk besoj që e rrezikon, as të Kosovës e cila ka mundësi financimin e një autostrade në shumën prej 800mil. Më befason qëndrimi i Ministrit të FSK-së për këtë çështje, i cili do të duhej të mbronte me vendosmëri pjesëtarët e FSK-së. I qëndroj mendimit të mëhershëm për Ligjin për pjesëtarët e FSK-së, jam kundër vendimit të Presidentes, dhe si anëtar i Komisionit do të votoj kundër vendimit dhe sugjerimeve për këtë ligj, dhe jam për formën fillestare të ligjit pa paragrafin e propozuar.

Fatmir Xhelili- Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa theksoi që çdo skemë pensionale do të ketë paragrafin i cili parasheh shkurtime, dhe bazohet në këtë paragraf kur të miratohen ligje të tilla, gjithashtu edhe FMN-ja do të bazohet në përgjegjësinë që marrim si shtet. FMN-ja vetëdijëson që të jemi përgjegjës dhe obligues në situata të caktuara për ekonominë dhe financat. Asnjë indikator nuk është për drejtime të tilla, por secili duhet të pyes vetën mos po rrezikojmë diçka më të madhe duke dashur të mbrojmë

1400 pensione, eventualisht të zvogëluara në një periudhë kohore, që është e pa pritur, duke humbur përkrahjen e FMN-së, ku për anëtarësimin në të kemi bërë shumë mund, duke dëshmuar përgjegjësi.

Relacionet e FMN-së me Bankën Botërore janë të lidhura ngushtë dhe do të kemi nevojë për ndihmën dhe financimin e tyre. Më vjen mirë që Ministri i FSK-së, Komandanti i FSK-së dhe Sekretari i Ministrisë së FSK-së e kanë kuptuar peshën dhe përgjegjësinë e momentit duke e mbështetur kërkesën për të përfshirë paragrafin në ligjin ekzistues, prandaj duhet ta mendojmë që mos po çrregullojmë raporte më të mëdha se në politikën e brendshme.

Agim Çeku- Nuk e pranoj çfarëdo kritike kinse ne, Ministria e FSK-së nuk mbron ushtarët, ne i mbrojmë dhe për këtë qëllim kemi bërë ligj të veçantë për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, bashkë me mbështetjen e Komisionit për Punë të brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Ne po diskutojmë për një paragraf i cili 90% nuk do të ketë nevojë të implementohet. Paragrafi i cili i referohet se “Qeveri mund të merr vendim” dhe jo “do të merr vendim”.

Të gjithë këtu përfaqësojmë diçka, interesin e vendit dhe subjektin që përfaqësojmë, prandaj z. Emin Gërbeshi, ju këtu përfaqësoni një koalicion, je i votuar për Parlament dhe të kisha sugjeruar të jesh më i përgjegjshëm në qëndrimet e tua, siç shpreheni që “nuk e pranoni vendimin e Presidentes, marrëveshjet e Qeverisë”

Si anëtarë të Qeverisë jemi të thirrur për të mbrojtur interesin kombëtar, ligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së pa paragrafin e sugjeruar e dëmton interesin e vendit, pasi Qeveria ka nënshkruar marrëveshje me FMN-në, mbështetja e së cilës është shumë e rëndësishme. Në marrëveshjen mes Qeverisë dhe FMN-së këto kufizime do të jenë për çdo ligj që nxirret, prandaj në rast krizash fillimisht pagat do të shkurtohen dhe nuk do të jenë pensionet.

Prezenca ime në Komision është për ta mbrojtur ligjin, pasi për këtë ligj ka nevojë FSK-ja, debatet e tilla vonojnë dhe si FSK nuk ndihemi mirë që të shkaktojmë probleme me FMN-në, kjo është arsyeja që kërkojmë që të mbështetet vendimi i Presidentes dhe që është Presidente e vendit.

Kryetari i Komisionit- Së pari ne jemi deputet që përfaqësojmë qytetarët e Kosovës, shtresat e qytetarëve dhe mundohemi të mbrojmë të gjitha kategoritë, në rastin konkret FSK-në. Presidentja ka të drejtë të marrë vendim, por jo çdo vendim i Presidentes kur vjen në Parlament mundet të kalojë, pasi Parlamenti është organi më i lartë i vendit që merr vendime përfundimtare, prandaj nuk është mirë ti ndajmë.

Ne nuk mundemi kur Qeveria ka prishur raporte me FMN-në dhe tani me pensione të pjesëtarëve të FSK-së të rregullojmë imazhin me këtë kategori. Në lidhje me paragrafin, secili shpreh qëndrimin e vet, pasi qëllimi është të kemi një Polici dhe Ushtri të fortë, dhe për këtë qëllim kemi këmbëngulur për këto dy institucione,

në mënyrë që të kemi një sistem të sigurisë që të jetë në nivel. Për çështjen në fjalë në seancë do të vendoset.

Emin Gërbeshi- Adresimi i juaj Ministër Çeku, ndaj meje nuk më pëlqeu. Këtu nuk e paraqes mendimin e Behxhet Pacollit e as të Agim Çekut, por paraqes mendimin e atyre që më kanë votuar. Unë nuk jam sahanlëpirës që të vijë me direktiva të Kryetarit të Partisë, por paraqesë mendimet e mija rreth çështjeve që diskutojmë, ju gjatë fushatës elektorale keni deklaruar që jeni në favor të FSK-së, pensioneve, rritjes së rrogave. Në prag të zgjedhjeve Kryeministri ka marrë vendim, i cili ka tejkaluar parashikimet e FMN-së dhe të qytetarëve të Kosovës, dhe raportet me FMN-në janë rregulluar pa asnjë problem, prandaj më vjen keq për një qëndrim të tillë të Ministri të Qeverisë së Kosovës.

Është njerëzore mbrojtja e dinjitetit të ish ushtarëve të UÇK-së, madje edhe me sakrificë. Vendimi i Presidentes është skandaloz, pastaj deklarimi i Qeverisë se *mund* të marrim vendim për shkurtime të pensioneve, nuk është e sigurtë, duhet të kemi qëndrim institucional që të gjithë pjesëtarët e FSK-së në pension të mund të paguhen nga paratë e taksapaguesve, dhe jo sa herë diskutohet për ish ushtarë të ketë komplikime në legjislacion.

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa- Fondi Monetar Ndërkombëtar, nuk kontrollon vetëm politikat fiskale të Kosovës, FMN nuk ka theksuar që për FSK-në të ketë shkurtime për pensionet, çështja është për tërë skemën sociale në Kosovë. Me gjithë vështirësitë në hartimin e ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së dhe shqetësimet për këtë ligj, e njëjta gjë duhet të ndodhe edhe për Ligjin për rastet sociale, i cili është miratuar në Kuvend, dhe në rast të shkurtimeve edhe për këtë kategori ka vështirësi, prandaj nuk është vetëm çështje e FSK-së, invalidëve të luftës por është e tërë skemës sociale në Kosovë.

Propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa është: *Në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik apo që përndryshe të siguroj ruajtjen e disiplinës fiskale publike Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshoj një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo beneficioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë benificionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.*

Rexhep Selimi- Ajo çfarë duhet të kemi të qartë është arsyeja pse është kthyer ligji. Arsye tjetër ka Presidentja, tjetër Qeveria dhe tjetër Ministria e FSK-së dhe arsyeja e Komisionit që mos të kthehet ligji. Arsyeja e Presidentes është se ky ligj dëmton interesat e vendit, arsyeja e Qeverisë është marrëveshja me FMN-në, arsyeja e Ministrisë së FSK-së është përshpejtimi i pensionimit të pjesëtarëve të FSK-së.

Presidentja ka bërë gabim me kthimin e këtij ligji, me gjithë respektin, pasi shfrytëzon nenin e Kushtetutës që i jep të drejtë të kthej ligjin, duke mos qenë ajo arsye. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk duhet ta luaj rolin e mirëmbajtjes së raporteve të prishura me FMN-në mes Qeverisë.

Presidentja ka të drejtë vetëm njëherë të kthej ligjin, nëse ne e dërgojmë në seancë në formën si është, Ligji për pensionet e pjesëtarëve FSK-së kalon.

Ganimete Musliu- Këshilla e miqve ndërkombëtar nuk duhet marrë si presion, për ruajtjen e raporteve me FMN-në, sepse nëse kjo ka ndodhur njëherë prishja e raporteve, nuk duhet të lejojmë që kjo gjë të përsëritet, dhe unë nuk konsideroj gabim vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave.

Konsideroj që duhet përkrahur vendimi i Presidentes dhe të miratohet edhe në Komision, pasi Komisioni ka bërë një punë të mirë dhe ka qenë unik edhe në seanca parlamentare kemi dal unik dhe bashkëpunues, prandaj konsideroj që kjo është një sfidë të cilët duhet ta kalojmë si Komision dhe seancës ti propozojmë që vendimi i Presidentes të miratohet.

Fatmir Xhelili- Propozoj Komisionit që Ligji për Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së me vendimin e Presidentes ta dërgojmë në Kuvend dhe Kuvendi të vendos, pasi është çështje serioze, pra nuk votoj që propozimi i Presidentes të kthehet, por propozoj që të dërgohet në Kuvend.

Shkëlzen Sylaj- Çështja e nenit 27 të Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, nuk është diskutuar me FMN-në nga Ministria e FSK-së, është diskutuar për përqindjen dhe shkallën e pensionit. Pas takimit Komisioni për Buxhet dhe Financa me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ka qenë konform marrëveshjes që të futet për tërë skemën pensionale. Në takimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e të gjitha partive dhe në mënyrë unanime është miratuar Amendamenti shtesë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, Ministria e FSK-së e kemi pranuar në parim këtë Amendament, në mënyrë që të jemi në hap me kohën për fillimin e implementimin e këtij ligji që është nevojë imediate e FSK-së. Çështja e vendimmarrjes ju përket juve, FSK-së i duhet ligji për hapat e mëtutjeshëm. Si Komision do të keni mundësi që në fazat e ardhshme të bëni ndërhyrjet e duhura në të mirë të skemës pensionale të institucioneve të sigurisë, dhe për këtë arsye na duhet përkrahja juaj për miratimin e ligjit.

Kryetari i Komisionit- Nuk do të ketë zvarritje për miratimin e ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, pasi kthimi i projektligjit e ka një afat të caktuar kur trajtohet në Komision dhe shkon në seancën plenare, votohet ose kundërshtohet. Në bazë të afatit që e kemi, do ta procedojmë projektligjin bashkë me vendimin e Presidentes dhe seanca vendos, duke qenë se nuk ka konsensus për këtë çështje.

Agim Çeku- Është e rëndësishme për FSK-në që të ketë Ligjin për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, me apo pa paragrafin e propozuar nga Presidentja, ju jemi mirënjohës Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së për mbështetjen por për arsye praktike dhe interes të vendit kemi kërkuar që ta mbështesni vendimin e Presidentes.

Kryetari i Komisionit- Në afatin e mjaftueshëm për seancë do të jetë ligji në Kuvend, dallimet që janë kanë qëllimin e mirë, për të pasur një ligj të mirë. Në seancë do të vendosin deputetet dhe ligji e merr formën e prerë kur të votohet tani pasi të dërgohet në seancë.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë të rendit të ditës kam disa njoftime. Për dy ditë me radhë 23-24 prill, 2012 është organizuar Konferenca për Evropën Juglindore nga NATO-ja, në Tiranë. Në këtë Konferencë kanë marrë pjesë përfaqësues të shteteve, ne kemi përfaqësuar delegacionin nga Kosova me dy Nënkryetarët e Kuvendit dhe Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Në fund të Konferencës është nënshkruar një deklaratë për bashkëpunimin e vendeve të rajonit, në takim nuk ka marrë pjesë delegacioni nga Serbia, nga Nënkryetari z. Xhavit Haliti është arsyetuar që mund të jenë zgjedhjet në Serbi. Kosova është përfaqësuar me situatën që ka, me ndihmën e KFOR-it që ka në Kosovë.

Tema e kësaj Konference ka qenë “Mbrotje e zgjuar” me moton, shpenzime më pak dhe efikasitet më shumë.

Në vizitën studimore në Ljublanë e organizuar nga DCAF-i, kanë qenë të paraparë që dy anëtarë të Komisionit të marrin pjesë, kamë kërkuar që edhe për dy anëtarë të rritet numri. Kërkesa është miratuar vetëm për Kryetarin e Komisionit por jo për z. Fatmir Xhelili i cili është propozuar për këtë vizitë, por arsyetimi nga organizatorët ka qenë se jemi vonë në kohë.

Me 2 maj 2012, për vizitë do të jetë Kryetarja e Komisionit të Bundestagut gjerman, Suzan Kasner, është paraparë një drekë punë, jeni të ftuar të gjithë anëtarët e Komisionit.

Rexhep Selimi- Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor me këtë datë 24.04.12, ka mbajtur takimin e parë, të pranishëm kemi qenë, Kryesuesi dhe z. Anton Quni, z. Fatmir Xhelili dhe z. Goran Marinković nuk kanë qenë të pranishëm për arsye subjektive.

Në këtë takim është miratuar një pyetësor që ka të bëjë me mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së këtij Ligji, jemi orientuar edhe me agjendën, të riformulohet për shkak të vonësave nga vizita në Gjermani dhe zhvillimet parlamentare.

Për shkak të pamundësisë për të mbajtur takimin sot, materiali për këtë grup punues do tu përcillet me e-mail, agjenda, kohën e vizitave në Institucionet që do ti vizitojmë, në mënyrë që para datës 7 maj kur do të jemi në vizitë në Ljublanë, të bëhen këto vizita që të jemi në kohë me realizimin e agjendës për ta përmbyllur këtë mbikëqyrje në sesionin pranveror.

Kryetari i Komisionit- Nëse nuk keni çështje të tjera për të shtruar, me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi